

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“E.S.E.C” SHPK

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

Z. Edmond Dako, lindur ne Durres, Shqiperi, me 31.10.1962, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar nepermjet leternjofimit me numer 034359921 dhe numer personal ID G21031046F, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, person i mesiperm eshte Ortaku i Vetem si me poshte:

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar “E.S.E.C” SHPK.

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne : S.Z. Xhafzotaj, zona Kadastale 2574 me nr Pasurie159/211 Durres, Shqiperi.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Shoqeria “E.S.E.C” SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Shoqeria “E.S.E.C” SHPK zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Prodhim Energji Elektrike, prodhim Energji Elektrike nga burime alternative, veprimtari e tregtimit të energjis elektrike, Bujqesi, prodhim dhe tregtim te produkteve bujqesore, Frutikulture Blegtori, prodhim dhe tregtim te produkteve blegtoriale, Import, Eksport dhe sherbime.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe/ose jashte saj.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfiton Ortaku i Shoqerise.

Ortaku themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne

Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortaket.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 100,000 (njeqind mije) Lek, e perbere nga Ortaku i Vetem Themelues,
Z. Edmond Dako, 1 (nje) kuote me vlere 100,000 (njeqind mije) Lek.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Ortaku i Vetem pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon Ortakut themelues.

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Neni 11

ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET

Ne shoqerine "E.S.E.C" SHPK administrator i shoqerise do te jete: **Z. Edmond Dako**, lindur ne Durres, Shqiperi, me 31.10.1962, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me numer 034359921 dhe numer personal ID G21031046F, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Mbyllja e Shoqerise:

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Ortaku i Vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqeria likujdohet:

Neni 13

Ortaku i Vetem emerohet likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku i Vetem. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Date 17/11/2021

E.S.E.C SHPK

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Edmond Dako